



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
REKTORATI

Tiranë, më 04.09. 2018

NJOFTIM

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit me Nr.150, dt.04.09.2018 “Mbi shpalljen e kriterëve për lëvizjet e brendshme paralele të një personeli akademik (Lektor), pranë Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik (Lektor) ,(Levizje paralele), pranë Departamentit të Sportit, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, në lëndën **Futboll** , se duke filluar nga data **04.09.2018** deri më **10.09.2018 ora 14⁰⁰** duhet të dërgojnë pranë Protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

Kandidatët duhet të plotësojnë keto kriterë:

1. Preferohen me notë mesatare sa më të lartë
2. Te zotëroj një gjuhë të huaj (preferohet gjuha Angleze)
3. Të ketë së paku gradën “Doktor”
4. Kanë preferencë pedagogët me grada e tituj: Prof.As., Prof.Dr.
5. Fusha e studimit dhe diplomimit duhet të përputhet me lëndën mësimore që do të zhvillojë sipas departamentit ku aplikon.
6. Të ketë përvojë mësimdhënie në Arsimin e lartë.
7. Të ketë veprimtari shkencore si: referime, botime .Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar.
8. Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.
9. Intervista

Aplikimet e personelit akademik të brendshëm duhet të bëhen brenda 5 (pesë) ditë pune, pranë protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, kjo do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail kandidatit.

PS: Kandidati që shpallet fitues duhet të plotësojë **60** pikë e lart.

R E K T O R

Prof. Dr. Agron CUKA